
Formulari 3- TEKSTI I THIRRJES PUBLIKE



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - Direktorat za Kulturu, Omladinu i Sport
Department of Culture, Youth and Sport - Kültür, Gençlik ve Spor Müdürlüğü

PËR/ZA/TO:					
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:			Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport		
NGA/OD/FROM:			**Kushtrim Zeqiri** **Drejtor**		
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:			**Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare për OJQ Kulturore dhe Individ, për organizimin e manifestimit kulturor ''Flaka e Janarit 2026''**		
Nr. i Zyrës: Br. Kancelarije: Room No:	/	Lokacioni: Lokacija: Extencion:	**Gjilan**	Data: Datum: Date:	**12.10.2026**

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr.: 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe në Rregulloren së Komunës së Gjilanit për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve Nr.016-126422, dt.29.12.2016,, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport-Gjilan shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Thirrje publike për OJQ dhe Individ, të ofrimit të mbështetjes financiare publike për organizimin e manifestimit kulturor "Flaka e Janarit 2027".

1. ***Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport*** u bën thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës së të cilave është i fokusuar në fushën e ***Kulturës*** të aplikojnë për mbështetje financiare me projektet e tyre për organizimin e Manifestimit mbarëkombëtar "**Flaka e Janarit 2027**".

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/propozimet e tyre për organizimin, konceptimin dhe realizimin e fushave/shtyllave kryesore dhe percjellëse të manifestimit, si në vijim:

Shtyllat kryesore:

- ***Akademia e Flakës***
    - *Pjesa e muzikes klasike*
- ***Arti dramatik*** *-"Talia e Flakës" - Festivali i Dramës Shqipe*
- ***Arti pamor*** *- ''Peneli i Flakës'' – Ekspozitë Grupore e Artit Pamor*
- ***Arti letrar*** *- ''Pena e Flakës''*
- ***Arti muzikor*** *- ''Fest Flaka''*
- ***Koncerti për fëmijë-*** *''Yjet e Flakës''*

Shtyllat organizative përcjellëse nga Komuna:

-Brendimi i Flakës (Nga Dizajneri-DKRS)
-Operatorët ekonomik
-Grupet punuese

Kushtet dhe Kriteret e Përgjithshme të Manifestimit

- Projektet e propozuara duhet tu përmbahen datave të implementimit të aktiviteteve sipas programit të manifestimit "Flaka e Janarit 2027" nga data 11.01.2027 deri më 31.01.2027;
- Projektet duhet përmbajnë projektin ideor të konceptuar me shtjellimin e idesë dhe planin për realizim;
- Specifikacionet financiare të detajuara;
- Të ofrojnë ide kreative dhe të pa publikuara më parë.
- Të ofrojnë projekte të specifikuara dhe përshkrimin e përgjithshëm të projektit.
- Të ofrojnë dëshmi për përvojat e mëparshme në teatër, skenografi, muzikë, letërsi dhe arte pamore.
- Të ofrojnë dëshmi për aftësi organizative për shtyllat përcjellëse të flakës.
- Synimi i DKRS-së është të nxisë krijimtarinë artistike, krijuese të të gjitha formave që përfaqësojnë vlera.
- Vazhdimësia artistike e "Flakës së Janarit'', paraqitje inovative.
- Pasurimi i shprehjes krijuese artistike bashkëkohore.

SHTYLLAT KRYESORE

1. '' Akademia e Flakës'' Pjesa e Muzikës Klasike

•*1a* -Akademia e Flakës-Pjesa e muzikës klasike

Kush mund të aplikojë:

• OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të profilizuara në fushën përkatëse, me përvojë të dëshmuar në atë sektor, dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

• Individët nga Komuna e Gjilanit.

Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

• Nëse ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, të ofrojë dëshmi se ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2025.

• Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;

• Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

• Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrje publike.

- E njëjta OJQ mund të jetë partnere edhe në shtyllat e tjera të thirrjes.

Kriteret e veçanta për OJQ të përcaktuara me dispozitat në vijim:

• OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën përkatëse;

• Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore);

Kriteret e veçanta për individ të përcaktuara me dispozitat në vijim:

• Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore).

- Individët obligohen të aplikojnë me koncept të shkruar ose vizual(draft) unik të planifikimit.

Procedurat e organizimit

• **1a-** Akademia e Flakës-''Pjesa e muzikës klasike''

-OJQ/Individ Përfitues/e e Akademia e Flakës-''Pjesa e muzikës klasike''i jep të dhëna dizajnerit të shtyllës organizative përcjellëse nga DKRS ''Brendimi i Flakës''për nevojat e materialeve dizajnuese.

- Përfituesi i "Akademia e Flakës-Pjesa e muzikës klasike'' koordinohet me organizatorët (Komuna e Gjilanit/Zyra e Kryetarit) e pjesës konceptuale të Akademisë së flakës për harmonizimin dhe mbarëvajtjen e programit.

- Përfituesi i Akademia e Flakës-''Pjesa e muzikës klasike''kontrakton moderator/e për udhëheqjen e programit.

- Përfituesi i Akademia e Flakës-''Pjesa e muzikës klasike'' mund të shfrytëzoj resurset si; Operatorin ekonomik për shtyp (vetëm materiale promovuese: Mirenjohje, banerë, folio, poster. Përjashtohen katalogjet, librat si dhe përjashtohet përkrahja si nga vitet e kaluara për: transport, zërim, binë dhe ndricim).

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.01.2027.

Totali i shumës për mbështetje në këtë shtyllë:

• Shuma totale e mbështetjes është **3,500.00** Euro

Shkalla e mbështetjes për OJQ:

• Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 3,500.00 Euro

• Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro

Shkalla e mbështetjes për Individ:

• Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 3,500.00 Euro

• Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro.

2.“Talia e Flakës” - Festivali i Dramës Shqipe

Kush mund të aplikojë:

• OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të profilizuara në fushën përkatëse, me përvojë të dëshmuar në atë sektor, dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

• Nëse ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, të ofrojë dëshmi se ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2025.

• Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;

• Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

• Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrje publike.

- E njëjta OJQ mund të jetë partnere edhe në shtyllat e tjera të thirrjes.

Kriteret e veçanta për OJQ të përcaktuara me dispozitat në vijim:

• OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën përkatëse;

• Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore);

Procedurat e organizimit

-OJQ Përfituese e '' Talia e Flakës'' i jep të dhëna dizajnerit të shtyllës organizative përcjellëse nga DKRS ''Brendimi i Flakës''për nevojat e materialeve dizajnuese.

- OJQ Përfituese e '' Talia e Flakës'' Fton dhe akomodon jurinë profesionale për përcjelljen e dramave dhe ndarjen e çmimeve fituese.

- OJQ Përfituese e '' Talia e Flakës'' komunikon me Udhëheqësinë e Teatrit për koordinim teknik të programit, duke përfshire itinerarin e shfaqjeve, diskutimeve etj.

- OJQ Përfituese e '' Talia e Flakës'' shfrytëzon burimet njerëzore dhe resurset logjistike të Teatrit si dhe Operatorin ekonomik për shtyp (vetëm materiale promovuese: Mirenjohje, banerë, folio, poster. Përjashtohen katalogjet, librat si dhe përjashtohet përkrahja si nga vitet e kaluara për: transport, zërim, binë dhe ndricim).

- OJQ Përfituese e '' Talia e Flakës'' akomodon ansamblet e Teatrove pjesëmarrëse sipas nevojës.

-Organizon kokteje dhe diskutime formale në Teatër pas cdo drame.

- OJQ Përfituese e '' Talia e Flakës'' fton mysafirë dhe të nominuarit për çmimet e ''Talia e Flakës'' ne harmonizim me DKRS si organizative për ''Gala mbrëmjen'' që do të organizohet nga këta të fundit.

-OJQ Përfituese e '' Talia e Flakës'' ndanë gjithsej 6 (gjashtë) çmime:

1. Shfaqja më e mirë
2. Teksti më i mirë
3. Regjia më e mirë
4. Aktorja më e mirë
5. Aktori më i mirë
6. Inovacioni më i mirë(skenografi, kostumografi, dizajn i dritave, kompozim dhe koreografi)

- OJQ Përfituese e '' Talia e Flakës'' kontrakton moderator/e për udhëheqjen e programit.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.01.2027.

Totali i shumës për mbështetje në këtë shtyllë:

• Shuma totale e mbështetjes është **22,000.00** Euro

Shkalla e mbështetjes për OJQ:

• Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 22,000.00 Euro

• Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro

3. '' Peneli i Flakës''

Kush mund të aplikojë:

• OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të profilizuara në fushën përkatëse, me përvojë të dëshmuar në atë sektor, dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

• Nëse ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, të ofrojë dëshmi se ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2025.

• Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;

• Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

• Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrje publike.

- E njëjta OJQ mund të jetë partnere edhe në shtyllat e tjera të thirrjes

  Kriteret e veçanta për OJQ të përcaktuara me dispozitat në vijim:

• OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën përkatëse;

• Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore);

- E njëjta OJQ mund të ketë edhe partneritet me ndonjë OJQ tjetër për bashkëorganizim.
- OJQ duhet të aplikoj me koncept kuratorial mbi ekspozitën.

Procedurat e organizimit

-OJQ Përfituese e '' Peneli i Flakës'' i jep të dhëna dizajnerit të shtyllës organizative përcjellëse nga DKRS ''Brendimi i Flakës''për nevojat e materialeve dizajnuese.

-OJQ Përfituese e '' Peneli i Flakës'' përveç ekspozitës që si vend kyç e ka hapësirën e Galerisë, mund të zgjeroj ekspozitën me vepra artistike nëpër objeket kulturore të Qytetit si psh: Muzetë e Qytetit, hapësira alternative etj.

-OJQ Përfituese e'' Peneli i Flakës'' akomodon mysafirët(nëse ka) dhe obligohet të organizoj koktej rasti gjatë hapjes së ekspozitës.

- OJQ Përfituese e '' Peneli i Flakës'' shfrytëzon resurset si Operatorin ekonomik për shtyp (vetëm materiale promovuese: Mirenjohje, banerë, folio, poster. Përjashtohen katalogjet, librat si dhe përjashtohet përkrahja si nga vitet e kaluara për: transport, zërim, binë dhe ndricim).

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.01.2027.

Totali i shumës për mbështetje në këtë shtyllë:

• Shuma totale e mbështetjes është **5,000.00** Euro

Shkalla e mbështetjes për OJQ:

• Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 5,000.00 Euro

• Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro

4. '' Pena e Flakës''

Kush mund të aplikojë:

• OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të profilizuara në fushën përkatëse, me përvojë të dëshmuar në atë sektor, dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

- Individët nga Komuna e Gjilanit.

Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

• Nëse ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, të ofrojë dëshmi se ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2025.

• Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;

• Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

• Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrje publike.

- E njëjta OJQ mund të jetë partnere edhe në shtyllat e tjera të thirrjes.

Kriteret e veçanta për OJQ të përcaktuara me dispozitat në vijim:

• OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën përkatëse;

• Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore);

- E njëjta OJQ mund të ketë edhe partneritet me ndonjë OJQ tjetër për bashkëorganizim.

Kriteret e veçanta për individ të përcaktuara me dispozitat në vijim:

• Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore).

- Individët obligohen të aplikojnë me koncept të shkruar ose vizual(draft) unik të planifikimit.

Procedurat e organizimit

-OJQ/Individ Përfitues/e e '' Pena Flakës'' i jep të dhëna dizajnerit të shtyllës organizative përcjellëse nga DKRS ''Brendimi i Flakës''për nevojat e materialeve dizajnuese.

- OJQ/Individ Përfitues/e e ''Pena e Flakës'' komunikon me DKRS si organizatore e Mbylljes Solemne të Festivalit të Flakës së Janarit.

- OJQ/Individ Përfitues/e e ''Pena e Flakës'' përveç programit të paraparë sipas aplikimit, obligohet të organizoj dhe realizoj edhe garën e Enigmatëve, dhe ndanë 1/4 e buxhetit përfitues për këtë garë.

- OJQ/Individ Përfitues/e e '' Pena e Flakës'' shfrytëzon resurset; Operatorin ekonomik për shtyp (vetëm materiale promovuese: Mirenjohje, banerë, folio, poster. Përjashtohen katalogjet, librat si dhe përjashtohet përkrahja si nga vitet e kaluara për: transport, zërim, binë dhe ndricim).

- OJQ Përfituese e '' Pena e Flakës'' kontrakton moderator/e për udhëheqjen e programit.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.01.2027.

Totali i shumës për mbështetje në këtë shtyllë:

• Shuma totale e mbështetjes është **6,500.00** Euro

Shkalla e mbështetjes për OJQ:

• Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 6,500.00 Euro

• Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro

Shkalla e mbështetjes për Individ:

• Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 6,500.00 Euro

• Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro.

5. '' Fest Flaka''

Kush mund të aplikojë:

• OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të profilizuara në fushën përkatëse, me përvojë të dëshmuar në atë sektor, dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

• Nëse ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, të ofrojë dëshmi se ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2025.

• Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;

• Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

• Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrje publike.

- E njëjta OJQ mund të jetë partnere edhe në shtyllat e tjera të thirrjes.

Kriteret e veçanta për OJQ të përcaktuara me dispozitat në vijim:

• OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën përkatëse;

• Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore);

- E njëjta OJQ mund të ketë edhe partneritet me ndonjë OJQ tjetër për

bashkëorganizim.

Procedurat e organizimit

-OJQ Përfituese e '' Fest Flaka'' i jep të dhëna dizajnerit të shtyllës organizative përcjellëse nga DKRS ''Brendimi i Flakës''për nevojat e materialeve dizajnuese.

-OJQ Përfituese e '' Fest Flaka'' fton dhe akomodon sipas nevojës jurinë profesionale për ndarjen e çmimeve fituese.

- OJQ Përfituese e '' Fest Flaka'' komunikon me udhëheqësinë e Teatrit për koordinim teknik të programit.

- OJQ Përfituese e '' Fest Flaka'' shfrytëzon resurset njerëzore dhe logjistike të Teatrit si dhe Operatorin ekonomik për shtyp (vetëm materiale promovuese: Mirenjohje, banerë, folio, poster. Përjashtohen katalogjet, librat si dhe përjashtohet përkrahja si nga vitet e kaluara për: transport, zërim, binë dhe ndricim).

-OJQ Përfituese e '' Fest Flaka'' organizon festivalin me karakter garues dhe ndanë çmimet sipas vetë-planifikimit.

- OJQ Përfituese e '' Fest Flaka'' kontrakton moderator/e për udhëheqjen e programit.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.01.2027.

Totali i shumës për mbështetje në këtë shtyllë:

• Shuma totale e mbështetjes është **12,500.00** Euro

Shkalla e mbështetjes për OJQ:

• Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 12,500.00 Euro

• Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro

6. Koncerti për fëmijë ''Yjet e Flakës''

Kush mund të aplikojë:

• OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të profilizuara në fushën përkatëse, me përvojë të dëshmuar në atë sektor, dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

• Nëse ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, të ofrojë dëshmi se ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2025.

• Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;

• Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

• Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrje publike.

- E njëjta OJQ mund të jetë partnere edhe në shtyllat e tjera të thirrjes.

Kriteret e veçanta për OJQ të përcaktuara me dispozitat në vijim:

• OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën përkatëse;

• Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore);

- E njëjta OJQ mund të ketë edhe partneritet me ndonjë OJQ tjetër për bashkëorganizim.

Procedurat e organizimit

-OJQ Përfituese e '' Yjet e Flakës'' i jep të dhëna dizajnerit të shtyllës organizative përcjellëse nga DKRS ''Brendimi i Flakës''për nevojat e materialeve dizajnuese.

-OJQ Përfituese e festivalit për fëmijë ''Yjet e Flakës'' fton dhe akomodon sipas nevojës jurinë profesionale për ndarjen e çmimeve fituese.

- OJQ Përfituese e festivalit për fëmijë ''Yjet e Flakës'' koordinohet me udhëheqësinë e Teatrit për mbarëvajtjen e programit.

- OJQ Përfituese e festivalit për fëmijë ''Yjet e Flakës'' shfrytëzon resurset; Operatorin ekonomik për shtyp (vetëm materiale promovuese: Mirenjohje, banerë, folio, poster. Përjashtohen katalogjet, librat si dhe përjashtohet përkrahja si nga vitet e kaluara për: transport, zërim, binë dhe ndricim).

-OJQ Përfituese e '' Yjet e Flakës'' organizon festivalin me karakter garues dhe ndanë çmimet sipas vetë-planifikimit.

- OJQ Përfituese e festivalit për fëmijë ''Yjet e Flakës'' kontrakton moderator/e për udhëheqjen e programit.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.01.2027.

Totali i shumës për mbështetje në këtë shtyllë:

• Shuma totale e mbështetjes është **5,000.00** Euro

Shkalla e mbështetjes për OJQ:

• Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 5,000.00 Euro

• Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro

Vlerësimi i projekt-propozimeve do të zhvillohet në dy faza:

Faza I: Vlerësimi administrativ, që identifikon nëse aplikuesi ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta

të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

Faza II: Vlerësimi i përmbajtjes:

- Nëse aplikuesi është i profilizuar në fushën përkatëse me atë projekt që aplikon;
- Nëse aplikuesi ka paraparë respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë në zbatimin e projekt-propozimit të paraqitur në këtë thirrje publike;
- Nëse aplikuesi posedon kapacitete profesionale dhe teknike për të zbatuar aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;
- Nëse është përcaktuar ekipi i projekt-propozimit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit;
- Nëse projekt-propozimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrje publike;
- Nëse projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse;
- Nëse aktivitetet e projekt-propozimit janë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë reale karshi rezultateve specifike dhe kohëzgjatjes së pritshme të projekt-propozimit;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Aplikimi:

Të gjitha detajet e aplikimit duhet të lexohen në formularin: Udhëzimet për Aplikantët, i cili është publikuar në kuadër të kësaj thirrje.

Afati për aplikim:

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projekt-propozimet që janë pranuar brenda afatit të paraparë, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara me këtë thirrje publike. Afati i fundit për aplikim është 15 ditë pune nga dita e shpalljes së kësaj thirrje publike dhe përfundon me datën: 30 Tetor 2026, në ora 16:00.

Më shumë informacione rreth thirrjes publike:

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë

elektronike, duke dërguar pyetjet e mundshme jo më pak se 8 ditë para përfundimit të thirrjes për aplikim.

E-mail : dkrs.gjilan@rks-gov.net;